

**Beqir META**

**Hasan BELLO**

## **SHTYPI AMERIKAN MBI NGJARJET NË KOSOVË NË VITIN 1981**

(Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore “Demonstratat e vitit 1981  
në Kosovë”

organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2021)

Demonstratat që shpërthyen në pranverën e vitit 1981 e vendosën Kosovën dhe popullin shqiptar në fokus të medias botërore. Ato gjetën pasqyrim në shtypin dhe opinionin publik ndërkombëtar jo vetëm në Evropë, por edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ajo që të bie në sy është jo vetëm numri i madh i artikujve që janë botuar, por dhe shtrirja e tyre në shumë organe të shtypit e sidomos trajtimi i këtyre ngjarjeve disa herë në gazetat më të njohura të SHBA-së. Sipas të dhënave të mbledhura nga përfaqësia shqiptare në OKB (e cila ishte e vetmja ambasadë në New York, sepse zyrtarisht qeveria shqiptare nuk kishte marrëdhënie diplomatike me SHBA-të), deri në muajin qershor të vitit 1981 mbi ngjarjet në Kosovë dhe mbi materialet e shtypit shqiptar lidhur me këtë çështje kishin shkruar 46 gazeta dhe ishin botuar mbi 123 artikuj. Për sa i përket tipologjisë, 61 prej tyre ishin artikuj të gjatë komentues, 48 artikuj të shkurtër me karakter informues, 10 të marra nga gazetat e tjera dhe 4 të marra nga agjencia “Tanjug”.

Ngjarjet në Kosovë u pasqyruan në gazetat më prestigjioze, siç ishte “New York Times” e cila botoi 13 artikuj. Më pas vinin periodikë të tjerë po aq të njohur, por të një tirazhi më të ulët, si “Washington Post”, “Times Herald” me 7 artikuj; “Chronicle” (Houston, Tex) me 6 artikuj; “World” dhe “Chronicle” (San Francisko) me 5 artikuj; “Free Press”, “News Day”, “The Times” (Los Angeles) me 4 artikuj; “Star Indianapolis”, “Christian Science Monitor”, “The New York Post”, “Sun Times”, “News World”, “Morning Sun”, “Boston Globe” me nga 3 artikuj; “Star Washington”, “Morning News”, “Herold American”, “News American”, “Courant Hartford”, “Journal Providence”, “News”, “Republican”, “Journal”, “American”, “Post Dispatch” dhe

revista “World Press Review” me nga 2 artikuj dhe 17 gazeta të tjera, të cilat kishin botuar vetëm nga një artikull.<sup>1</sup>

Autorët që kishin shkruar më shumë për këto ngjarje ishin Marvine Howe, korrespondent special i gazetës “New York Times”, i cili kishte shkruar 5 artikuj; Eric Bourne, korrespondent special i gazetës “Christian Science Monitor” në Vjenë, i cili kishte shkruar 3 artikuj dhe Anthony Barbieri, korrespondent i gazetës “Morning Sun”, i cili kishte shkruar 2 artikuj. Një gazetar tjetër që shkruante shpesh për vendin tonë, megjithëse për ngjarjet në Kosovë kishte shkruar vetëm një herë, ishte dhe korrespondenti i gazetës “Washington Post”, Michael Dobbs.

Demonstratat e Kosovës bënë që shtypi amerikan ta rikthente edhe një herë vëmendjen ndaj Shqipërisë komuniste. Kjo për shkak të qëndrimeve që ajo mbante lidhur me këto demonstrata. Në shtypin jugosllav aludohej hapur për gjoja implikimin që Tirana zyrtare dhe Enver Hoxha kishin në këto ngjarje dhe për nxitjen e demonstratave.

Shtypi amerikan nuk reagoi menjëherë për demonstratat e Prishtinës, që në fillim të muajit prill 1981. Ky qëndrim nuk ishte i rastësishëm, por i mirë menduar dhe në përputhje me politikën amerikane ndaj Jugosllavisë. Në këtë qëndrim shprehej në një farë mase dëshira e qeverisë amerikane për t'i treguar udhëheqjes jugosllave se, edhe pse nuk mund ta aprovonte politikën e masave shtypëse që aplikonte kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, SHBA po mbanin një qëndrim të rezervuar për hir të miqësisë së vjetër që ekzistonte midis këtyre vendeve dhe si shpërblim i shërbimeve të mëdha që elita politike jugosllave i kishte bërë politikës amerikane. Me këtë të fundit nënkuptohej roli që Tito dhe jugosllavët kishin luajtur si përfaqësues të vendeve të paangazhuara dhe rivalitetit sovjetiko-amerikan që kishte përfshirë mbarë botën gjatë Luftës së Ftohtë.

Një arsye tjetër e ngathtësisë që kishte treguar shtypi amerikan ndaj ngjarjeve në Kosovë ishte fakti se ato nuk bënë pjesë në repertorin tradicional të problemeve me të cilat merreshin këto gazeta. Në fokus të tyre ndodheshin shtete apo pjesë të ndryshme të kontinenteve që deri në këtë periudhë konsideroheshin zona të nxehta. Ndërsa Kosova dhe shqiptarët e Jugosllavisë nuk ishin shquar asnjë herë pas Luftës së Dytë Botërore si një problem i qenësishëm edhe nga vetë shteti

---

<sup>1</sup> AQSH, F.14/APSTR, D. 28, V.1981, fl.86. Relacion i përfaqësisë shqiptare në OKB mbi jehonën e shtypit amerikan mbi ngjarjet në Kosovë, New York, 11 korrik 1981.

shqiptar në ndonjë forum apo organizatë ndërkombëtare. Por mbi të gjitha, theksonte përfaqësia shqiptare në New York, shtypi amerikan sado që konsiderohej i lirë dhe i padisciplinuar, ai i ndiqte dhe i nuhaste tendencat zyrtare të qeverisë amerikane. Kjo e fundit nuk ishte e interesuar që në këtë moment, kur komunizmit po i vinte fundi në mbarë botën, çështja e Kosovës të merrte publicitet; të theksohej se në Jugosllavi ekzistonte një situatë kaotike politike. Në këtë periudhë politika amerikane ishte e interesuar që konfrontimin e saj me politikën sovjetike ta kufizonte më tepër në disa zona të tjera larg Ballkanit.

Në ditët e para shtypi amerikan nuk ishte objektiv lidhur me ngjarjet në Kosovë. Kjo vinte për shkak se ai i referohej kryesisht shtypit jugosllav, agjencisë së lajmeve “Tanjug” dhe zyrtarëve të lartë të Jugosllavisë. Trajtimi i këtyre ngjarjeve, duke iu referuar burimeve jugosllave, bëri që lajmet dhe artikujt e botuar ditët e para të mos pasqyronin siç duhej arsyet historike dhe politike që i kishin shtyrë studentët shqiptarë të hidheshin në demonstrata. Në shkrimet e botuara në këto organe konstatohej hapur ndikimi i tezave të historiografisë dhe propagandës serbo-sllave lidhur me pozitën historike dhe juridike të shqiptarëve brenda Jugosllavisë. Prandaj shtypi amerikan nuk kishte qenë në gjendje të zbulonte dhe të shtjellonte si duhej për opinionin dhe lexuesin e tij shkaqet e vërteta dhe të gjithë kontekstin historik dhe bashkëkohor të shpërthimit të demonstratave, si dhe të dhunës e terrorit serb për t`i shtypur ato.

Por me kalimin e kohës, kur ngjarjet e Kosovës tërhoqën vëmendjen e shtypit dhe të shteteve evropiane, edhe në shtypin amerikan ndryshoi qasja ndaj demonstratave të 1981. Botimi i një numri të madh shkrimesh jo vetëm me karakter informues, por edhe komentues, sidomos javën e dytë pas demonstratave të 1 dhe 2 prillit, ishin shenjat e para se ai nuk mund të heshte e as t`i shmangej konkluzioneve dhe vlerësimeve që i imponoheshin nga ngjarjet. Arsyet që e detyruan shtypin amerikan të dilte nga pozita e mëparshme duhen kërkuar në radhë të parë në vetë përmasat e përpjesëtimet që morën demonstratat e shqiptarëve të Kosovës. Kjo në të gjitha dimensionet. Me këtë kemi parasysh numrin e pjesëmarrësve, shkallën e shtrirjes së tyre dhe kërkesat që shtruan për zgjidhje, të cilat ishin të atilla që as mund të shtypeshin lehtë e pa zhurmë, siç kërkonte të bënte qeveria jugosllave, e as të mbuloheshin e të liheshin në heshtje dhe, aq më pak, të shtrembëroheshin me epitetet që i vinte shtypi jugosllav.

Reflektimi i shtypit amerikan duhet kërkuar gjithashtu edhe në presionin që ushtroi opinioni i përparuar ndërkombëtar nëpërmjet shtypit.<sup>2</sup>

Nga një vështrim i përgjithshëm që mund t'i bëhet shtypit amerikan mbi ngjarjet në Kosovë në vitin 1981 konstatohen lehtësisht disa pikëpamje kryesore:

1. Në të gjitha shkrimet e botuara pranohej hapur se Kosova ishte krahina më e varfër e Jugosllavisë dhe se problemet ekonomike ishin një nga shkaqet kryesore të demonstratave të vitit 1981. Lidhur me këtë problem, gazeta "New York Times" e datës 11 maj 1981 shkruante se një zyrtar i partisë komuniste kishte vënë në dukje gjatë një interviste se në Klinë, komuna më e varfër në Kosovë, të ardhurat për frymë ishin rritur nga 62 dollarë që ishin në vitin 1949, në 363 dollarë në vitin 1980. Por ai shtonte se ajo qëndronte shumë pas komunave veriore rreth Lubjanës, që kishin afërsisht 7500 dollarë të ardhura për frymë.

Ndërsa një gazetë tjetër po aq e njohur amerikane, "Christian Science Monitor" e datës 21 maj shkruante se, pavarësisht nga prioriteti financiar, Kosova qëndronte në fund të përgjithshëm jugosllav. Të ardhurat mesatare vjetore për frymë ishin më pak se 1/3 e mesatares së Jugosllavisë që ishte 2700 dollarë dhe sa 1/7 e mesatares së Sllovenisë që ishte 5400 dollarë. Në po këtë artikull pasqyrohej një fakt interesant që paraqiste gjendjen e vërtetë të rënduar ekonomike të popullsisë shqiptare në Kosovës. Sipas këtij artikulli, Kosova banohej nga 7% e popullsisë së Jugosllavisë, por përfitonte më pak se 3% të prodhimit të përgjithshëm kombëtar.

Në gazetën "Boston Globe" të datës 18 qershor, midis të tjerave, thuhej se shqiptarët që vinin në SHBA deklarorin se hendeku i thellë ekonomik mes Kosovës dhe pjesës tjetër të Jugosllavisë po vinte duke u thelluar; se sistemi jugosllav i socializmit "Laise Faire" (në shqip lëre të rrjedhë, për ekonominë), nuk rezultonte efektiv; se si shqiptarët e Kosovës trajtoheshin në mënyrë të atillë që ta ndjenin veten inferior në Federatën Jugosllave. Po për këtë problem "Christian Science Monitor" e datës 8 prill shkruante se, në dukje, ishin kushtet ekonomike që kishin nxitur demonstratat e 1 dhe 2 prillit. E gjithë Jugosllavia, sipas saj, ishte në rënie. Por Kosova, e cila kishte një popullsi prej 1.6 milion banorë, nga të cilët 3 në 4 vetë etnikisht ishin shqiptarë, ishte goditur më rëndë. Kjo për shkak se Kosova ishte një nga krahinat më të varfra të Ballkanit. Sipas

---

<sup>2</sup> Po aty, fl.87-89.

gazetës në fjalë, popullsia e kësaj krahine kishte pasur një rënie të ndjeshme të standardit të jetesës, ndonëse dy dekadat e fundit nga federata kishte marrë një lloj ndihme të kufizuar.<sup>3</sup>

1. Në shtypin amerikan, kërkesa e popullsisë shqiptare të Kosovës dhe e demonstratave të pranverës së vitit 1981 për statusin e Republikës në kuadër të Federatës Jugosllave konsiderohej një kërkesë e drejtë. Për këtë gazeta “New York Times” e datës 27 prill 1981 theksonte se, ndërsa shteti federativ jugosllav kishte 6 republika, çfarë do t’i sillte asaj një republikë më shumë? Pse Kosova të mos ishte republikë kur 85% e banorëve të saj ishin etnikisht shqiptarë? Në një artikull tjetër të gazetës “Christian Science Monitor” të datës 21 maj shkruhej se bërja e Kosovës republikë do të forconte sistemin, duke shërbyer si një përfundim logjik i procesit. Ajo mbështeste pikëpamjet e shqiptarëve që artikulonin këto kërkesa, duke theksuar se shpejt ose vonë ajo do të realizohej, sepse nuk kishte asnjë rrugëzgjdhje tjetër jo vetëm për të ruajtur paqen në Kosovë, por edhe sigurinë në një zonë të ndjeshme të Ballkanin.

2. Në shumë artikuj dhe analiza të shtypit amerikan të kësaj periudhe flitej hapur se Jugosllavia dhe elita e saj politike nuk e dëshironte avancimin e statusit juridik të Kosovës nga frika se mos ajo e përdorte atë si një mjet që, në një të ardhme të afërt, të shpëruhej. Lidhur me këtë pikëpamje në gazetën “Christian Science Monitor” të datës 21 maj shkruhej: “Në fakt, Kosova ka tashmë autonominë lokale. Zyrtarët e Beogradit, të ndodhur nën presionin e fortë të lobit serb, pretendojnë se bërja e Kosovës republikë mund të çojë në shkatërrimin e gjithë federatës dhe të konceptit të vetë administrimit”.<sup>4</sup>

3. Lidhur me pasqyrimin e strukturës etnike të popullsisë së Kosovës mund të thuhet se në shtypin amerikan vihen re shifra të përafërta, me ndonjë diferencë të vogël, që provonin se pjesa dërrmuese e kësaj popullsie përbëhej etnikisht nga shqiptarët. Në disa raste numri i saj jepej edhe më pak se 85%. Por ajo që binte në sy në këto shkrime ishte fakti se shpesh herë shqiptarët konsiderohen si “minoritetet” dhe jo si “nacionalitet” shqiptar. Nuk mungonin as tendenca që serbët e Kosovës të paraqiteshin si popullsi autoktone, ndërsa shqiptarët si popullsi e ardhur. Kështu, në një artikull të gazetës “Boston Globe” të datës 18 qershor, midis të tjerave, thuhej se “...në mesjetë, si pjesë e shtetit të Rashës, Kosova ishte shtëpia e dinastisë së themeluesve të Serbisë dhe vendi i Patrikanës ishte në qytetin e Pejës. Pastaj erdhën turqit që u shtrinë në

---

<sup>3</sup> *Po aty*, fl.90.

<sup>4</sup> *Po aty*, fl.91.

Evropë. Në vitin 1389 në rrafshinën e Kosovës, afër Prishtinës, turqit mundën ushtrinë serbe dhe sunduan vendin për 500 vjet të tjera. Megjithëse shumë prej serbëve u larguan në veri, duke lejuar fiset shqiptare që të plotësojnë boshllëkun, Kosova u bë vendi i kombit serb dhe i hakmarrjes së përgjakshme”.<sup>5</sup>

4. Në të gjitha komentet mbi ngjarjet në Kosovë që u botuan në shtypin amerikan pohohej njëzëri se shteti komunist shqiptar, nuk kishte gisht në demonstratat e 1981-it. Kjo përbënte një lloj lehtësimi për Tiranën zyrtare, e cila ishte distancuar publikisht nga akuzat e shtypit të Beogradit. Për ta ilustruar këtë, po i referohemi gazetës amerikane “Christian Science Monitor” të datës 21 maj, e cila shkruante: “Me hamendje po e akuzojnë Shqipërinë për ndërhyrje e nxitje. Por nuk ka prova se regjimi i Tiranës ishte ose është më shumë se sa simpatizues i kërkesës së demonstruesve që Kosovës t’i jepet statusi i plotë i republikës”.<sup>6</sup> Ndërsa akoma me objektivitet konstatohet një analizë e gazetës “Boston Globe” e datës 18 qershor ku thuhet: “Sigurisht është më e lehtë për të qortuar një djall të jashtëm se sa një kalbëzim të brendshëm dhe shqiptarët e regjimit të Enver Hoxhës që jetojnë të mbyllur përbëjnë një rast të mrekullueshëm për të ngatërruar gjurmët”.<sup>7</sup>

Shtypi amerikan pasqyrore hipokrizinë e deklaratave të autoriteteve jugosllave për akuzat ndaj Tiranës zyrtare lidhur me një implikim të saj të mundshëm në demonstratat e vitit 1981.

5. Një fakt i rëndësishëm që vihet re në shtypin amerikan është se në të gjitha analizat e artikujt e botuar arrihej në përfundimin se, popullsia shqiptare në Jugosllavi trajtohej si një kategori e dorës së dytë krahasuar kjo me kombësitë e tjera shtet-formuese të kësaj federate. Kjo del qartë në një artikull të gazetës “News World” të datës 13 prill ku shkruhet se: “Shqiptarët u ankohen gazetarëve se jetojnë si qytetarë të dorës së dytë në tokën që ishte e tyre shumë kohë përpara se Zoti të vendoste që këtu të vinin serbët, kroatët dhe turqit”.<sup>8</sup> Ndërsa gazeta “Christian Science Monitor” e datës 8 prill shkruante se: “Edhe pse tradicionalisht ruajnë krenarinë kombëtare, kosovarët akoma vuajnë nga një kompleks inferioriteti. Serbët dhe anëtarët e kombësive të tjera

---

<sup>5</sup> *Po aty*, fl.92.

<sup>6</sup> *Po aty*.

<sup>7</sup> *Po aty*.

<sup>8</sup> *Po aty*, fl.93.

shpesh i shohin me nënvleftësim ata”.<sup>9</sup> Po për këtë problem, në gazetën “Boston Globe” të datës 18 qershor shkruhej: “Shqiptarët kanë qenë gjithnjë qytetarë të kategorisë së dytë në vendin e sllavëve të jugut dhe si myslimanë në një vend të krishterëve. Ata janë më të varfrit e të varfërve, akoma në pjesën më të madhe fshatarë analfabetë. Nëqoftëse ata largohen nga Kosova për të kërkuar punë, gjuha e tyre është e pakuptueshme për jugosllavët e tjerë. Ata bëjnë kryesisht punë të mbetura si portierë, pjatatarës dhe lustraxhinj...”.<sup>10</sup>

6. Për sa i përket numrit të pjesëmarrësve në demonstrata, në shtypin amerikan jepen shifra kontradiktore. Kjo për shkak se ata i referohen kryesisht të dhënave që vijnë nga burimet zyrtare jugosllave. Kështu, herë kjo shifër është 20.000, herë 10.000 dhe herë të tjera 2.000 protestues. Ndërsa për numrin e viktimave, kjo shifër ndryshon nga 9 në 11 të vrarë.

7. Në shtypin amerikan pasqyrohej edhe qëndrimi i shtypit shqiptar ndaj demonstratave të Prishtinës. Në këto shkrime vihej theksi tek mbrojtja e popullsisë shqiptare në Kosovë dhe tek fakti se Shqipëria nuk kishte pretendime territoriale ndaj fqinjët të saj ballkanik. Gjithashtu pasqyroheshin deklaratat dhe shkrimet të cilat hidhnin poshtë akuzat e Beogradit lidhur me një shpërthim që kishte ndodhur në ambasadën shqiptare në Tiranë.<sup>11</sup>

Në këto shkrime pasqyrohej edhe dëshira e Tiranës zyrtare për të vazhduar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me Jugosllavinë, si dhe “për të luftuar krah për krah me popullin jugosllav në qoftë se ai sulmohej nga imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik”. Për mendimin tonë, kjo përbënte dhe deklaratën më absurde, por dhe më domethënëse që tregon se qeveria komuniste e Tiranës dhe Enver Hoxha, më tepër se për interesat e shqiptarëve të Kosovës, ishin të interesuar për të ruajtur pushtetin e tyre, pavarësisht se si trajtoheshin shqiptarët në Federatën Jugosllave.<sup>12</sup>

8. Në shtypin amerikan flitej veçanërisht për gjendjen e rëndë që ekzistonte në Kosovë dhe për masat drastike që ishin duke marrë autoritetet jugosllave për të kontrolluar situatën politike. Këto shkrime përmbanin disa të dhëna konkrete lidhur me masat që mori qeveria jugosllave; flitej për mbylljen e Universitetit të Prishtinës dhe shkollave të tjera të larta e të mesme në Kosovë; për

---

<sup>9</sup> *Po aty.*

<sup>10</sup> *Po aty.*

<sup>11</sup> *Po aty*, fl.94.

<sup>12</sup> *Po aty*, fl.95.

ushtrinë dhe forcat speciale të policisë e sigurimit që vazhdonin të qëndronin në qytetet të ndryshme të Kosovës; për 100 demonstrues që ishin arrestuar dhe pritej që të dilnin përpara gjyqit; për 500 demonstrues që ishin gjobitur dhe 150 të tjerë të ngarkuar me akuza më serioze dhe të papërcaktuara; për 450 anëtarë partie që ishin përjashtuar si pjesëmarrës në demonstrata, duke përfshirë 105 mësues dhe 99 studentë; për 189 veta që ishin qortuar rëndë, duke përfshirë 109 mësues dhe 300 studentë që ishin përjashtuar nga shkolla etj.<sup>13</sup>

Në shtypin amerikan pasqyrohej edhe mendimi i disa personaliteteve perëndimore, sipas të cilëve fryma e protestave kishte filluar të përhapej edhe në qytetet e tjera të Kosovës.

Si përfundim mund të thuhet se shtypi amerikan, në përgjithësi, mbajti një qëndrim objektiv ndaj demonstratave të vitit 1981. Ky qëndrim erdhi duke u kristalizuar gjithnjë e më shumë në favor të shqiptarëve dhe kundër politikës shtypëse dhe diskriminuese të autoriteteve jugosllave.<sup>14</sup>

---

<sup>13</sup> *Po aty*.

<sup>14</sup> *Po aty*, fl.96.